

L I G J
Nr. 8819, datë 27.9.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUVAJTIAN “PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB”, PËR PROJEKTIN E DYTË TË REHABILITIMIT TË UJITJES”

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian “Për zhvillimin ekonomik arab” për projektin e dytë të rehabilitimit të ujitjes”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3114, datë 3.10.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJA

E HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT KUVAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

PROJEKTI I DYTË I REHABILITIMIT TË UJITJES
(FAZA II)

Marrëveshja e datës 5.2.2001 midis Republikës së Shqipërisë (e quajtur këtej e tutje Huamarrësi) përfaqësuar nga Qeveria e Shqipërisë nga njëra anë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (i quajtur këtej e tutje Fondi) nga ana tjetër.

Huamarrësi i kërkuar Fondit ta ndihmojë në financimin e Projektit të Dytë të Rehabilitimit të Ujitjes të përshkruar në listën 2 të kësaj Marrëveshjeje (i quajtur këtej e tutje Projekt);

Huamarrësi ka siguruar nga Shoqëria Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA) një kredi me një shumë ekuivalente me 24 milionë dollarë, nga e cila shuma prej 12 milionë dollarë do të dislokohet për të ndihmuar në financimin e Projektit;

Huamarrësi zotohet të financojë koston e vlerësuar të Projektit që mbetet e pambuluar në monedhë lokale apo të huaj dhe çdo kosto tjetër që mund të rezultojë;

Qëllimi i Fondit është të ndihmojë vendet arabe dhe vendet e tjera në zhvillim për zhvillimin e ekonomisë së tyre, dhe t’u sigurojë atyre huatë e nevojshme për kryerjen e projekteve e programeve të tyre të zhvillimit; dhe

Fondi e kupton rëndësinë dhe dobishmërinë e Projektit në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

Fondi është dakord që sa më sipër, t’i japë një hua Huamarrësit sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje.

Prandaj palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Huaja, interesi dhe detyrimet e tjera ripagimi; vendi i pagesës

PARAGRAFI 1.01 Fondi është dakord që t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, një shumë ekuivalente me tre milionë e pesëqind mijë Dinarë Kuvajtian, (K.D 3 500 000).

PARAGRAFI 1.02 Huamarrësi do të paguajë një interes prej dy për qind (2%) në vit të shumës kryesore të huasë së tërhequr dhe të papaguar. Interesi do të fillojë nga data përkatëse që do të tërhiqen shumat.

PARAGRAFI 1.03 Do të paguhet një detyrim shtese prej zero pikë pesë përqind (1/2 e 1%) në vit në shumat e tërhequra nga huaja dhe të papaguara, për të përballuar shpenzimet administrative si dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 1.04 Detyrimi i paguar për angazhimet speciale të futura nga Fondi, me kërkesën e Huamarrësit sipas Paragrafit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje, do të jetë 0.5% (1/2 e 1%) në vit e shumës kryesore të çdo angazhimi special të papaguar.

PARAGRAFI 1.05 Interesat dhe detyrimet e tjera do të llogariten duke pasur si bazë 360 ditë të vitit dhe 12 muaj (30 ditë) për çdo periudhë më të shkurtër se 6 - mujore.

PARAGRAFI 1.06 Huamarrësi do të paguajë pjesën kryesore të Huasë sipas neneve të Ripagimit të paraqitur në Listën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 1.07 Interesat dhe detyrimet e tjera do të paguhen në periudha gjysmëvjetore në 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

PARAGRAFI 1.08 Huamarrësi ka të drejtë për pagesat e të gjithë interesit të rrjedhur dhe detyrimeve të tjera, për jo më pak se 45 ditë, të njoftojë Fondin për të paguar me avancë:

- a) të gjithë shumën e huasë në kohën e caktuar,
- b) të gjithë shumën e një ose më shumë periudhave, me kusht që në datën e kësaj parapagese nuk do të paguhet ndonjë pjesë e huasë pas asaj pjese që parapaguhet.

PARAGRAFI 1.09 Shuma e Huasë, interesi, si dhe detyrimet e tjera të saj, do të paguhen në Kuvajt ose në vende të tjera që Fondi do t'i quajë të arsyeshme.

Neni 2

Sigurimi i parasë

PARAGRAFI 2.01 Të gjitha llogaritë e trasaksioneve financiare të zbatuara në këtë Marrëveshje si dhe të gjitha shumat që hyjnë këtu, do të paguhen në Dinarë Kuvajtian.

PARAGRAFI 2.02 Sipas kësaj Marrëveshjeje, Fondi do të sigurojë, me kërkesën dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, aq para sa mund të kërkohej për pagesën e kostos së mallrave për t'u financuar nga Huaja ose për kthimin e një kostoje të tillë në atë monedhë në të cilën ajo kërkohej. Shuma që do të gjykohet për t'u tërhequr nga Huaja do të jetë e barabartë me shumën në Dinarë Kuvajtian të kërkuar për blerjen e shumës përkatëse të valutës.

PARAGRAFI 2.03 Kur ripagesa e shumës kryesore ose pagesa e interesit dhe detyrimeve të tjera mbi Huanë është bërë, Fondi me kërkesën dhe veprimin si një agjent për Huamarrësin, mund të sigurojë shumën e Dinarëve Kuvajtianë të kërkuar për një ripagesë të tillë, siç mund të jetë rasti, kundrejt pagesës nga Huamarrësi të shumës së kërkuar për këtë blerje në valutë ose valuta, siç mund të pranohet kohë pas kohe nga Fondi. Çdo pagesë që do t'i bëhet Fondit dhe që do të kërkohej në këtë Marrëveshje do të konsiderohet e efektshme vetëm kur Dinarët Kuvajtianë janë marrë nga Fondi.

PARAGRAFI 2.04 Kurdo që të jetë e nevojshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar vlerën e një monedhe në raport me një tjetër, kjo vlerë do të jetë e përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

Neni 3

Tërheqja dhe përdorimi i të ardhurave të Huasë

PARAGRAFI 3.01 Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Huaja shumat e shpenzuara ose që shpenzohen për Projektin, në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje.

Me përjashtim të rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, asnjë shumë nuk do të

tërhiqet nga Huaja për llogari të shpenzimeve të bëra përpara datës 1.1.2000.

PARAGRAFI 3.02 Sipas kërkesës së Huamarrësit dhe sipas afateve dhe kushteve që do të bihet dakort midis Fondit dhe Huamarrësit, Fondi mund të fillojë bisedimet (zotimet) e veçanta me shkrim, për t'i paguar shumat Huamarrësit, përsa i përket kostos së mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje, duke pasur parasysh pezullimet apo anulimet pasuese.

PARAGRAFI 3.03 Kur Huamarrësi do të dojë të tërheqë ndonjë shumë nga Huaja ose t'i kërkojë Fondit të fillojë bisedimet e veçanta sipas paragrafit 3.02, Huamarrësi do t'i dërgojë Fondit një kërkesë me shkrim në një formë të tillë, duke përmbytur ato deklarata, marrëveshje e dokumente të tjera, që Fondi do t'i quajë të arsyeshme.

Kërkesat për tërheqje me dokumentacionin e nevojshëm, siç thuhet në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe, do të bëhen menjëherë në lidhje me shpenzimet për Projektin.

PARAGRAFI 3.04 Huamarrësi do ta pajisë Fondin me dokumentet dhe evidencat, në mbështetje të kërkesës për tërheqje, siç do të kërkojë Fondi, në qoftë se Fondi më parë ose më pas do të ketë lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në lutje.

PARAGRAFI 3.05 Çdo kërkesë për tërheqje, e shoqëruar me dokumentet dhe evidencat e tjera, duhet të jetë e mjaftueshme për nga forma dhe përmbyajtja për ta bindur Fondin që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Huaja shumën dhe që shumat që tërhiqet nga kjo Hua përdoret vetëm për qëllimet e caktuara në Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 3.06 Huamarrësi do t'i përdorë të ardhurat e Huasë vetëm për të financuar koston e mallrave të kërkuara për të kryer Projektin e përshkruar në Listën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat specifike që financohen prej Huasë, metodat dhe procedurat për sigurimin e këtyre mallrave do të përcaktohen me marrëveshje midis Fondin dhe Huamarrësit, e cila mund të ndryshohet me marrëveshje midis tyre.

PARAGRAFI 3.07 Huamarrësi do t'i përdorë të gjitha mallrat e financuara prej të ardhurave të Huasë vetëm në realizimin e Projektit.

PARAGRAFI 3.08 Paga nga Fondi e shumave të cilat Huamarrësi ka të drejtë t'i tërheqë nga Huaja, do të bëhen me urdhër të Huamarrësit.

PARAGRAFI 3.09 E drejta e Huamarrësit të tërheqë nga Huaja do të përfundojë në 30 qershor 2003 ose në një datë tjetër për të cilën mund të bien dakord, herë pas here, midis Huamarrësit dhe Fondit.

Neni 4

Marrëveshjet e veçanta

PARAGRAFI 4.01 (a) Huamarrësi do t'i besojë Njesisë së Zbatimit të Projektit, e themeluar brenda Rregulloreve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në datën 5 prill 1999, (këtë e tutje e quajtur Njësia) kryerjen e Projektit dhe, për këtë qëllim, do t'i sigurojë këtë Hua kësaj Njësie.

(b) Huamarrësi do t'i sigurojë Njesisë staf të përshtatshëm, të gjitha mjetet dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Projektit me efikasitet.

PARAGRAFI 4.02 Huamarrësi do të koordinojë dhe monitorizojë zbatimin e projektit dhe do të mbikqyrë shlyerjen e detyrimeve të përfituesve në përputhje me politikën dhe procedurat e hartuara në Ligjin e Ujitjes dhe Kullimit, gjë që siguron realizimin e objektivave të Projektit.

PARAGRAFI 4.03 Në kuadrin e Huasë dhe shumës së dislokuar nga IDA për Projektin, Huamarrësi do t'i përdorë menjëherë të gjitha shumat e tjera të nevojshme në monedhë lokale apo të huaj, që do të kërkojnë për realizimin e Projektit, apo të çdo kostoje tjetër që mund të rezultojë, sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin.

PARAGRAFI 4.04 Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të njoftojë Fondin për përgatitjen, studimet, planet dhe specifikimet për Projektin, afatet e ekzekutimit të tij dhe ndonjë modifikim material i bërë këtë e tutje, me ato hollësi, siç mund t'i kërkojë Fondi kohë pas kohe.

PARAGRAFI 4.05 Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të kryejë Projektin me kujdesin dhe efektivitetin e duhur, si dhe në përputhje me praktikën e plotë inxhinierike, bujqësore, administrative dhe financiare.

PARAGRAFI 4.06 Për të kryer Projektin, Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të punësojë

konsulentë inxhinierë të përshtatshëm dhe, sipas afateve dhe konditave të kënaqshme për Fondin, të përgatisë dokumentet për tenderat e punimeve civile dhe supervizionin e punimeve të Projektit.

PARAGRAFI 4.07 Dhënia e kontratave për kryerjen e Projektit, të cilat do të financohen nga procedurat e Huasë dhe çdo ndryshim në to do të jenë subjekt i aprovimit të Fondit.

PARAGRAFI 4.08 (a) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që të mbajë dokumentacione të përshtatshme për të identifikuar mallrat e financuara prej Huasë, të sigurojë përdorimin e tyre vetëm për Projektin, të ndjekë progresin e Projektit (duke përfshirë edhe koston) dhe të reflektojë, në përputhje me praktikën e llogarisë së plotë praktikën financiare dhe veprimtarinë e Njësisë, do të krijojë mundësitë për përfaqësuesit e akredituar të Fondit që të bëjnë vizita për qëllime lidhur me Huanë, të shqyrtojnë Projektin, mallrat dhe çdo dokument përkatës dhe do t'i japë Fondit të gjitha informacionet që Fondi do të kërkojë, në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me shpenzimet që lidhen me Huanë, Projektin, mallrat dhe gjendjen financiare dhe veprimtarinë e Njësisë, në lidhje me Projektin.

(b) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë (i) të mbajë një llogari speciale për Fondin; (ii) të mbajë dokumentacionin e burimeve financiare dhe kostot përkatëse; dhe (iii) të kryejë kontrolle periodike për të siguruar që dokumentacioni financiar është i besueshëm, i kompletuar dhe në përputhje me afatet kohore.

(c) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë, që në përputhje me Projektin, të mbajë në dispozicion gjendjen e saj financiare për çdo kontroll financiar vjetor që do të kryhet nga revizorë të pavarur e të pranuar nga Fondi, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranura dhe të sigurojë Fondin brenda një periudhe 6 - mujore nga mbyllja zyrtare e vitit financiar me një kopje të vlerësimeve të kontrollit financiar.

(d) Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë që, brenda një periudhe 6 - mujore nga mbyllja zyrtare e vitit financiar t'i sigurojë Fondit (i) një buxhet të konsoliduar që të tregojë të ardhurat dhe shpenzimet e FSHPU-ve dhe SHPU-ve brenda zonës ku shtrihet Projekti; dhe (ii) një kontroll financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të konsoliduara për secilën nga FSHPU-të apo SHPU-të e përmendura më lart.

PARAGRAFI 4.09 Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë për të garantuar me siguri të përshtatshme të gjitha mallrat e financuara prej Huasë. Një sigurim i tillë do të mbulojë rreziqe të tilla si transporti dhe incidente të tjera me rrezik për blerjet dhe importet e mallrave në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimit të tyre në zonën e Projektit dhe do të jetë, për shumën të tilla, sa do të jenë edhe praktikën e plota tregtare. Ky sigurim do të paguhet me monedhën me të cilën paguhet kostoja e mallrave të siguruara ose me monedhën e konvertueshme lirisht.

Huamarrësi do të ngarkojë Njësinë të nxjerrë e të mbajë, me siguri të përshtatshme përgjegjëse, sigurimin kundrejt rreziqeve në zbatimin e Projektit në shumën të tilla të pajtueshme me praktikën tregtare.

PARAGRAFI 4.10 Huamarrësi dhe Fondi do të koepërojnë plotësisht për të siguruar realizimin e qëllimit të huasë. Në fund, Huamarrësi do të caktojë Njësinë t'i japë Fondit çdo tre muaj nga data e kësaj Marrëveshjeje, raporte periodike për ekzekutimin e Projektit dhe gjendjen e përgjithshme të Huasë, si dhe informacione të tjera që Fondi do të kërkojë në lidhje me Projektin dhe Huanë.

Huamarrësi dhe Fondi, kohë pas kohe, do të shkëmbejnë mendimet nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, për sa i përket çështjeve lidhur me qëllimin e Huasë dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të saj. Huamarrësi do të njoftojë Fondin, menjëherë, për çdo kusht që ndërhyrë ose kërcënon të ndërhyjë në realizimin e qëllimeve të Huasë (duke përfshirë rritjen themelore në koston e Projektit) ose në mirëmbajtjen e shërbimeve të saj.

PARAGRAFI 4.11 Huamarrësi do të marrë të gjitha masat që do të jenë të nevojshme për ekzekutimin e Projektit dhe nuk do të marrë ose nuk do të lejojë që të merret ndonjë veprim që pengon ose ndërhyrë në ekzekutimin e Projektit ose në kryerjen e ndonjë nga klauzolat e kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 4.12 Huamarrësi:

(a) përpara se të mbarojë Projekti, do të riparojë të gjitha linjat elektrike të dëmtuara dhe instalimet në mënyrë që të sigurohet furnizimi me energji të pandërprerë i stacioneve të ujitjes dhe hidrovoreve në zonën e Projektit;

(b) do të riparojë dhe mirëmbajë gjatë gjithë kohës rrugët rurale në zonën e Projektit në mënyrë që të kemi akses në zonën e Projektit;

(c) do të sigurojë qëndrueshmërinë e digave (veçanërisht atyre të vogla e të mesme si dhe

rezervuarëve) në zonën e projektit gjatë të gjithë kohës, dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për të arritur objektivin e sipërpërmendur;

(d) do të hartojë dhe zhvillojë një kuadër ligjor dhe institucional për sigurinë e digave dhe të pajisë Fondin me një kopje të materialit të lartpërmendur;

(e) do të ndërtojë dhe mirëmbajë sistemet e kontrollit të prurjes;

(f) do të monitorizojë periodikisht bilancin ujor në zonën e Projektit dhe do të sigurojë shpërndarjen e sasisë së nevojshme të ujit në këtë zonë.

PARAGRAFI 4.13 Huamarrësi do të vazhdojë të punësojë, deri në mbylljen e Projektit, një drejtor të Njesisë, eksperiencën dhe kualifikimi i të cilit gjatë gjithë kohës do të jetë i pranueshëm nga Fondi.

PARAGRAFI 4.14 Huamarrësi:

(a) do të sigurojë që Projekti të jetë funksional dhe të mirëmbahet, do të funksionojë dhe mirëmbahen veprat e artit dhe objektet e tjera që nuk përfshihen në Projekt por ndikojnë në të, në përputhje me praktikën inxhinierike, bujqësore, financiare dhe administrative.

(b) do të sigurojë që Njësia do të pajisë Fondin menjëherë pas ekzekutimit të Marrëveshjes, për rishikim dhe aprovim, me një kopje të Manualit të Shfrytëzimit, në të cilin jepen procedurat e detajuara për supervizionin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin, supervizionin dhe trajnimin e FSHPU-ve dhe SHPU-ve në zonën e Projektit.

PARAGRAFI 4.15 Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në çdo kohë, për minimizimin e çdo efekti të dëmshëm për sa i përket ambientit në zonën e Projektit, efekt ky që mund të lindë si shkak i zbatimit të Projektit apo gjatë shfrytëzimit. Veçanërisht, Huamarrësi, me qëllim që të evitojë impaktet e dëmshme të rreshjeve të tepërta dhe depozitimeve të ngurta në rezervuare, kanale dhe shtrate lumenjsh, duhet të zhvillojë një politikë pyllëzimi të pjesës kodrinore dhe një kontroll të shfrytëzimit të kullotave.

PARAGRAFI 4.16 Huamarrësi duhet të zhvillojë, gjatë zbatimit të Projektit, një program trajnimi dhe aktivitete, bazuar në nevojat e përfituesve në zonën e Projektit, në të gjitha aspektet e menaxhimit të ujitjes dhe aplikimit të teknikave e metodave moderne. Njësia duhet të mbikqyrë zbatimin me efikasitet të programit të lartpërmendur. Gjithashtu, Njësia duhet të zhvillojë një program të përshtatshëm trajnimi për trajnimin e trajnuesve.

PARAGRAFI 4.17 Huamarrësi do të sigurojë që Njësia do të vazhdojë të funksionojë gjatë gjithë kohës, sipas rregullave dhe rregulloreve dhe të ketë fuqi të tillë që të drejtojë dhe administrojë për sa është e nevojshme, kryerjen me kujdes dhe efektivitet të Projektit dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të tij.

Huamarrësi, nën dritën e një kooperimi të frytshëm dhe duke bindur të dyja palët, do të informojë Fondin për çdo veprim të propozuar, i cili do të ndikonte në natyrën ose ndërtimin e Njesisë, si dhe do t'i japë Fondit të gjitha rastet e mundshme përpara ndërmarrjes së një veprimi të tillë, për t'i rishikuar këto ndryshime së bashku me Huamarrësin për sa i takon më sipër.

PARAGRAFI 4.18 është qëllimi reciprok i Huamarrësit dhe i Fondit që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë ndonjë prioritet mbi Huanë, nëpërmjet të drejtës së krijuar mbi pasurinë shtetërore. Huamarrësi merr përsipër që, përveç rasteve kur Fondi do të bjerë dakord ndryshe, në qoftë se do të krijohet ndonjë lënie pengu në pasurinë e Huamarrësit, si siguri për borxhin e jashtëm, ky lloj pengu do të përdoret si siguri për pagimin e shumës kryesore të Huasë, të interesit dhe të detyrimeve të tjera. Klauzolat e mëparshme të këtij Paragrafi nuk do të zbatohen në:

(i) ndonjë lënie pengu të krijuar në pasuri (prona) vetëm si siguri për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj prone;

(ii) ndonjë lënie pengu në mallrat tregtare për të siguruar një maturim borxhli jo më shumë se një vit pas datës në të cilën ajo ndodh, si dhe për ta paguar prej të ardhurave të shitjes së këtyre të ardhurave tregtare;

(iii) ndonjë lënie pengu e krijuar në drejtim të transaksioneve të bankës dhe të sigurimit të një maturimi të borxhit jo më shumë se një vit pas datës së dhënies.

Termi "pasuri" e Huamarrësit, siç është përdorur në këtë Paragraf, përfshin pasuritë e Huamarrësit ose të atij që ka të drejtë pronësie apo kontrolli nga Huamarrësi, ose nga ndonjë nënseksion politik, duke përfshirë Bankën Qendrore të Huamarrësit ose ndonjë institucion tjetër që kryen funksionet e Bankës. Termi "pengu", përfshin lënien peng, detyrimet, privilegjet dhe prioritetet e çdo lloji.

PARAGRAFI 4.19 Shuma themelore, interesi dhe të gjitha detyrimet e tjera mbi Huanë do të paguhet pa zbritje dhe pa përfshirë taksat që janë në fuqi sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve faktike në territorin e tij ose që do të jenë në të ardhmen.

Paragrafi 4.20 Kjo Marrëveshje do të jetë e çliruar nga çdo taksë, tatim, kuotë e çdo lloji që do të vihen sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve faktike në territorin e tij gjithashtu Huamarrësi do të paguajë taksa, tatime e kuota të tilla, në qoftë se ka, sipas ligjeve të vendit ose vendeve me monedhën e të cilëve paguhet Huaja apo ligjeve në territoret e këtij apo këtyre vendeve.

PARAGRAFI 4.21 Shuma kryesore, interesi dhe detyrimet e tjera të Huasë do të paguhet të çliruara nga të gjitha kufizimet, duke përfshirë dhe kufizimet e këmbimit të vëna sipas ligjeve të Huamarrësit.

PARAGRAFI 4.22 Të gjitha dokumentet, korrespondencat dhe materialet e tjera të ngjashme të Fondit do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje sekrete. Huamarrësi do t'i akordojë Fondit imunitet të plotë nga censurimi dhe inspektimi i botimeve.

PARAGRAFI 4.23 Të gjitha pasuritë dhe të ardhurat e Fondit do të çlirohen nga konfiskimi dhe shtetëzimi.

Neni 5 **Anulimi dhe pezullimi**

PARAGRAFI 5.01 Huamarrësi, me anë të njoftimit tek Fondi, mund të anulojë ndonjë shumë të Huasë, shumë të cilën ai nuk e ka tërhequr para një njoftimi të tillë. Huamarrësi nuk mund të anulojë ndonjë shumë të huasë për të cilën Fondi do të ketë filluar një bisedim të veçantë sipas Paragrafit 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.

PARAGRAFI 5.02. Fondi nëpërmjet njoftimit tek Huamarrësi, mund të pezullojë pjesërisht ose tërësisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr nga Huaja, në qoftë se ndodh dhe vazhdon ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:

(a) Kur ndodh një gabim në pagesën e shumës kryesore, në interesat ose pagesat e tjera të kërkuara sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshje tjetër të Huasë midis Huamarrësit dhe Fondit.

(b) Kur ndodh ndonjë gabim në kryerjen e ndonjë marrëveshjeje ose kontrata nga ana e Huamarrësi brenda kësaj marrëveshjeje.

(c) Fondi do të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të tërhequr sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër të huasë midis Huamarrësit dhe Fondit për shkak të ndonjë gabimi nga ana e Huamarrësit.

(d) Fondi IDA-s i dislokuar për projektin do të anulohet apo pezullohet dhe Huamarrësi nuk ka siguruar ndonjë alternativë tjetër për financim dhe kohe të arsyeshme dhe kushte të pranueshme nga Fondi.

(e) Një situatë e jashtëzakonshme e cila do ta bëjë të pamundur Huadhënësin të plotësojë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes.

Për çdo ngjarje që ndodh pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe përpara datës efektive që do t'i japë të drejtë Fondit të pezullojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë kërkesë dhe në qoftë se Marrëveshja është bërë efektive në datën që ka ndodhur ngjarja, Fondi ka të drejtë të pezullojë kërkesat nën Huanë nësoj sikur kjo ngjarje të ketë ndodhur pas datës efektive.

E drejta e Huamarrësit për të bërë kërkesa për Huanë do të vazhdojë të mbetet e pezulluar pjesërisht ose tërësisht, sipas rastit, përderisa ngjarja ose ngjarjet që shkaktuan një pezullim të tillë kanë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi do të njoftojë Huamarrësin që e drejta për të bërë kërkesë i është rikthyer; duke kuptuar që në rast të një njoftimi të tillë e drejta për të bërë kërkesë do të rikthehet vetëm pas përmbyshjes së kushteve të specifikuar në një njoftim të tillë, dhe njoftime të tilla nuk do të ndikojnë ose dëmtojnë ndonjë të drejtë, fuqi ose ndihmë të Fondit kundrejt ndonjë ngjarjeje të mëparshme të përshkruara në këtë Paragraf.

PARAGRAFI 5.03 Në qoftë se do të ndodhë ndonjë ngjarje e specifikuar në pikën (a) të Paragrafit 5.02 dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 30 - ditësh pas njoftimit të dhënë nga Fondi Huamarrësit, ose në qoftë se do të ndodhë një ngjarje e specifikuar në paragrafet (b), (c), (d) dhe (e) të paragrafit 5.02 dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 60 - ditësh, atëherë në kohën pasuese në vazhdimësi, Fondi mund të deklarojë që shumat kryesore e Huasë të paguhet menjëherë dhe sipas një

deklarate të tillë, kjo shumë e Huasë do të paguhet menjëherë.

PARAGRAFI 5.04 Nëqoftëse (a) e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Huaja do të pezullohet për një periudhë 30 - ditëshe ose (b) në datën e specifikuar në Paragrafin 3.09 si data e mbylljes, një shumë e Huasë do të mbetet e patërhequr. Fondi nëpërmjet njoftimit tek Huamarrësi, mund t'i japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqjen e kësaj shume. Me dhënien e këtij njoftimi kjo shumë e Huasë do të anulohet.

PARAGRAFI 5.05 Anullimet dhe pezullimet nga Fondi nuk do të zbatohen për shumatat e Huasë për angazhimet e veçanta të nisura nga Fondi në pajtim me Paragrafin 3.02.

PARAGRAFI 5.06 Vetëm në rastet kur Fondi do të bjerë dakord ndryshe, çdo pezullim do të zbatohet proporcionalisht në disa pagesa të shumës së Huasë të bëra pas datës së këtij pezullimi.

PARAGRAFI 5.07 Megjithë ndonjë pezullim ose anulim, të gjitha klauzolat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efektive, përveç si përcaktohet në këtë nen.

Neni 6

Detyrimet e Marrëveshjes Pushimi i ushtrimit të të drejtave; arbitrazhi

PARAGRAFI 6.01 Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe të detyrueshme në përputhje me nenet e pandryshueshme të ligjeve lokale. As Huamarrësi dhe as Fondi nuk kanë të drejtën për të shpallur ndonjë kërkesë që sigurimi i kësaj Marrëveshjeje është i pavleshëm ose jo i detyrueshëm për ndonjë arsye.

PARAGRAFI 6.02 Vonesat në ushtrimin ose lënia pas dore për të ushtruar çdo të drejtë ose fuqi të secilës palë sipas kësaj Marrëveshjeje për ndonjë të metë do të dobësojë këtë të drejtë e fuqi, gjithashtu dhe pranimi në heshtje i kësaj të metë do të pengojë e dobësojë të drejtën, fuqinë e secilës palë për sa i përket të metave të tjera pasuese.

PARAGRAFI 6.03. Çdo debat midis palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga cilado palë kundrejt tjetrës do të vendoset me marrëveshjen e palëve dhe në rast dështimi të kësaj Marrëveshjeje, debati ose pretendimi do të paraqitet në arbitrazh nga një trup gjykues e parashikuar në paragrafin në vazhdim.

PARAGRAFI 6.04 Trupi i arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjykatës të caktuar si më poshtë:

- arbitri i parë do të caktohet nga Huamarrësi;

- arbitri i dytë do të caktohet nga Fondi; dhe

- arbitri i tretë (këtej e tutje i quajtur Arbitër), do të caktohet nga marrëveshja e palëve ose në qoftë se ato nuk do të jenë dakord, nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesën e secilës palë. Në qoftë se secila palë nuk do të caktojë një arbitër, atëherë ky arbitër do të caktohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e ndonjërës prej palëve. Në rast se arbitri i caktuar sipas këtij Paragrafi, jep dorëheqjen, vdes ose s'është i aftë për të vepruar do të caktohet një arbitër tjetër pasardhës në të njëjtën mënyrë siç u përshkrua më lart, i cili do të ketë të gjitha fuqitë dhe detyrat e arbitrit të parë.

Procedura gjyqësore e arbitrazhit mund të caktohet, sipas këtij Paragrafi, me njoftimin nga pala që cakton këtë procedurë, drejtuar palës tjetër. Ky njoftim do të përmbajë një deklaratë duke paraqitur natyrën e debatit ose pretendimit që paraqitet në arbitrazh, emrin e arbitrit të caktuar nga pala kundërshtare.

Brenda 30 ditëve pas dhënies së këtij njoftimi, pala akuzuese njofton palën tjetër për procedurat e arbitrit dhe emrin e arbitrit të emëruar nga kjo palë.

Në qoftë se brenda 60 ditëve pas dhënies së këtij njoftimi palët nuk do të jenë dakord për zgjedhjen e një arbitri, ato mund të kërkojnë zgjedhje të Arbitrit, siç është përcaktuar në pjesën e parë të këtij paragrafi.

Trupi gjykues do të vendosë për kohën dhe vendin, siç do të fiksohet nga arbitri. Pra, Trupi Gjykues do të caktojë se ku dhe kur do të zhvillohet arbitrazhi.

Sipas neneve të këtij Paragrafi dhe përveç rasteve kur palët do të bien dakord ndryshe, Trupi Gjykues do të vendosë të gjitha çështjet që lidhen me kompetencat e tij si dhe do të vendosë procedurën. Këto vendime do të merren me shumicë votash. Trupi Gjykues do t'i thërrasë të gjitha palët për të dëgjuar dhe për të dhënë vendimin e Gjyqit me shkrim. Ky vendim mund të jepet edhe i gabuar prandaj një vendim i nënshkruar nga shumica e Trupit Gjykues do të përcaktojë vendimin e këtij trupi. Një kopje e vendimit do t'i transmetohet secilës palë. Çdo vendim i tillë i dhënë në

përputhje me klauzolat e këtij Paragrafi do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët e kësaj Marrëveshjeje. Çdo palë duhet të zbatojë këtë vendim të Trupit Gjykues.

Palët do të fiksojnë shumën e kuotës së arbitrazhit dhe të personave të tjerë që do të kërkohen për drejtimin e procedurës së arbitrazhit. Nëse palët nuk bien dakord për një shumë të tillë para vendimit të Trupit Gjykues, atëherë Trupi Gjykues do të fiksojë këtë shumë sipas kushteve. Secila palë do të paguajë shpenzimet e veta në procedurën gjyqësore të arbitrazhit. Shpenzimet e Trupit Gjykues do të ndahen midis dhe në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo problem i lidhur me ndarjen e shpenzimeve të trupit gjykues ose me procedurën për pagesën e këtyre shpenzimeve, do të caktohet nga Trupi Gjykues.

Trupi Gjykues do të zbatojë parimet e përgjithshme sipas ligjeve në fuqi të Huamarrësit dhe shtetit të Kuvajtit, si dhe parimet e drejtësisë.

PARAGRAFI 6.05 Klauzolat për arbitrazhin e paraqitur në Paragrafin e mëparshëm, do të jenë të vlefshme për çdo procedurë tjetër, për përcaktimin e debateve midis palëve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të çdo pretendimi të secilës palë ngritur kundrejt palës tjetër.

PARAGRAFI 6.06. Shërbimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me procedurat gjyqësore sipas këtij neni, mund të bëhet sipas mënyrës së cilësuar në Paragrafin 7.01. Palët në këtë Marrëveshje mund të heqin dorë nga kërkesat për shërbimin e një procesi ose njoftimi të tillë.

Neni 7

Klauzola të ndryshme

PARAGRAFI 7.01 Çdo njoftim apo kërkesë e lejuar ose e kërkuar për t'u bërë sipas kësaj marrëveshjeje, do të jetë me shkrim. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në paragrafin 8.03, ky

njoftim apo kërkesë do të gjykohej të bëhet në kohën e duhur kur ai do të dorëzohet dorazi ose me postë, teleks, telegram ose telefon në adresën e palës së specifikuar në këtë Marrëveshje ose në adresa të tjera që janë përcaktuar nga njoftimi i palës që e ka bërë këtë kërkesë ose ka dhënë këtë njoftim.

PARAGRAFI 7.02 Huamarrësi do të pajisë Fondin me evidencat e nevojshme të autorizimit të personit ose personave përgjegjës të cilët do të firmosin kërkesën e parashikuar në nenin 3, ose të personit që në emër të Huamarrësit do të fillojë të veprojë, të plotësojë dokumentet e kërkuara apo të lejuara për t'u bërë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe firmat origjinale të secilit prej këtyre personave.

PARAGRAFI 7.03 Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u kryer, çdo dokument i kërkuar për t'i plotësuar sipas kërkesave të kësaj Marrëveshjeje, në emër të Huamarrësit, mund të kryhet nga Ministri i Financës apo ndonjë person i autorizuar me shkrim nga ai. Çdo modifikim i klauzolave të kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i sipërpërmendur ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ai, duke u siguruar që, sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, ky modifikim është arsyetuar sipas kushteve dhe në thelb nuk do të rrisë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes. Fondi mund të pranojë kryerjen e veprimeve nga ky përfaqësues ose persona të tjerë, si dhe plotësimin e çdo dokumenti si përfundimtar që, sipas mendimit të tyre ky apo ai modifikim i klauzolave të Marrëveshjes është i arsyeshëm dhe ky plotësim nuk do të rrisë detyrimet e Huamarrësit.

Neni 8

Data efektive: përfundimi

PARAGRAFI 8.01 Fondi nuk do të jetë dakord me këtë Marrëveshje për ta bërë atë konkrete, derisa ai të jetë pajisur me evidencat e kënaqshme për të, që ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes në emër të Huamarrësit është autorizuar dhe miratuar nga të gjitha instancat e nevojshme qeveritare.

PARAGRAFI 8.02 Si pjesë e evidencës që duhet siguruar në vijim të Paragrafit 8.01, Huamarrësi do t'i japë Fondit një opinion ose opinione të autoriteteve kompetente duke treguar që kjo Marrëveshje është autorizuar, miratuar në kohë dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe që është një detyrim i vlefshëm i Huamarrësit sipas kushteve të saj.

PARAGRAFI 8.03 Përveç rasteve kur Fondi dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe në veprim në datën në të cilën Fondi njofton me teleks Huamarrësin për pranimin e evidencave të kërkuara prej tij në Paragrafin 8.01.

PARAGRAFI 8.04 Në qoftë se të gjitha veprimet e kërkuara për t'u kryer sipas Paragrafit 8.01, nuk do të jenë përfunduar para 90 (nëntëdhjetë) ditëve pasi të jetë nënshkruar kjo Marrëveshje ose në ndonjë datë tjetër që do të bien dakord Fondi dhe Huamarrësi, Fondi do t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet lajmërimit të Huamarrësit. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë.

PARAGRAFI 8.05 Në qoftë se dhe kur shuma kryesore e Huasë, interesi dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga Huaja do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe gjithë detyrimet e palëve do të marrin fund menjëherë.

Neni 9 Konkluzionet

PARAGRAFI 9.01 Përveç rasteve kur kërkohet ndryshe, termat që vijojnë kanë kuptimet e mëposhtme, kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje ose listë:

(1) Termi "Projekt" do të thotë: projekt ose projekte, program ose programe për të cilat jepet Huaja, siç përshkruhet në Listën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe përshkrimi do të përmirësohet kohë pas kohe sipas Marrëveshjes midis Fondit dhe Huamarrësit.

(2) Termi "mallra" do të thotë pajisje e shërbime të cilat kërkohen në Projekt. Kudo që është bërë referimi për koston e çdo malli, kjo kosto do të gjykohet duke përfshirë koston e importit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.

(3) Termi "përfitues" Federatat e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit (FSHPU) dhe Shoqatat e Përdoruesve të Ujit (SHPU), të cilat do të marrin pjesë në zbatimin e projektit të ujitjes në rrethet përkatëse dhe do të shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë veprat ujitëse në këto rrethe.

(4) Termi "Njësi" i referohet Njësisë së Zbatimit të Projektit të krijuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit sipas rregullores së datës 5 prill 1999.

Adresat që pasojnë janë dhënë për qëllime të Paragrafit 7.01

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Adresa alternative me telefon dhe teleks:

TelefonTeleksFaks

.....00355 42 28405

00355 42 29200

Për Fondin:

Fondi Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab

P.O.Box 2921, Safat

Kuwait -13030

Adresa alternative me telefon dhe teleks:

TelefonTeleks Faks

Alsunduk22025 Alsunduk00965 2419091

Kuwait22613 Kfaed Kt00965 2436289

Në prani të dëshmitarëve, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e firmosën këtë Marrëveshje me emrat përkatës dhe e dorëzuan në Tiranë, në tre kopje, e konsideruar secila si origjinali, me të njëjtin efekt për sa i përket ditës dhe vitit të shkruar më sipër.

Republika e Shqipërisë

Nga Anastas Angjeli

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga Abdulwahab Al-Bader
(Përfaqësuesi i autorizuar)

LISTA 1
KLAUZOLAT E SHLYERJES

Shuma totale e Huasë do të shlyhet në 36 këste gjashtëmujore, shuma dhe procedurat janë dhënë në listën e bashkëngjitur. Kësti i parë do të paguhet datën e parë kur interesat dhe detyra të tjera mbi Huanë do të bëhen efektive, në përputhje me klauzolat e Marrëveshjes së Huasë, pas një periudhe kohore ekstra 4 - vjeçare, duke filluar që nga data kur Fondi paguan çdo shumë në vijim të kërkesës së parë për tërheqje të bërë nga Huamarrësi ose nga data në të cilën Fondi ndërmerr një veprim në përputhje me Paragrafin 3.02 të Marrëveshjes së Huasë, në rast se kërkohet ndërmarrja e një veprimi të tilli, cilado datë të jetë më e hershme se tjetra. Këstet e mbetura të shlyerjes do të paguhet në mënyrë të vazhdueshme, çdo gjashtëmujor, pas datës kur kësti i parë bëhet efektiv.

ANEKSI I LISTËS 1
LISTA E AMORTIZIMIT

Sl. Nr	Pagesa (E shprehur në Dinarë Kuvajtian)
1	97.000
2	97.000
3	97.000
4	97.000
5	97.000
6	97.000
7	97.000
8	97.000
9	97.000
10	97.000
11	97.000
12	97.000
13	97.000
14	97.000
15	97.000
16	97.000
17	97.000
18	97.000
19	97.000
20	97.000
21	97.000
22	97.000
23	97.000
24	97.000
25	97.000
26	97.000
27	97.000
28	97.000
29	97.000
30	97.000
31	97.000
32	97.000
33	97.000
34	97.000
35	97.000
36	97.000
Total	3.500.000

Dinarë Kuvajtian tre milion e pesëqind mijë.

LISTA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti është një pjesë e programit të zhvillimit, i cili nisi në vitin 1993, dhe me qëllim rehabilitimin e skemave të ujitjes dhe kullimit në Shqipëri. Projekti synon të përmirësojë standardin e jetesës së fermerëve në zonën e Projektit dhe të forcojë ekonominë e vendit nëpërmjet rritjes së prodhimit bujqësor në shtatë rrethe: Vlorë, Elbasan, Lezhë, Korçë, Berat, Shkodër e Peqin. Projekti do të rehabilitojë 8 skema ujitjeje dhe kullimi në rrethet e lartpërmendura.

Projekti do të ketë këto komponentë kryesore:

1. Rehabilitimin e 8 skemave ujitëse dhe kulluese që mbulojnë një sipërfaqe prej 24,231 ha dhe sigurimin e të gjitha pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për stacionet e pompave, së bashku me të gjitha pajisjet ndihmëse.

2. Mbështetje financiare nëpërmjet asistencës teknike, trajnimit dhe sigurimit të pajisjeve për:

- formimin dhe funksionimin e SHPU-ve dhe FSHPU-ve;

- mbështetjen për ristrukturimin e drejtorive të ujrave;

- zhvillimin e praktikave të përshtatshme të kontraktimit.

3. Asistencë teknike për: përmirësimin e projekteve të ujitjes dhe kullimit të veprave dhe pajisjeve të stacioneve, hartimin e Manualit të Shfrytëzimit, kryerjen e inspektimit në lidhje me sigurinë e digave, studime teknike dhe për ruajtjen e ambientit.

4. Mbështetje njësisë së Projektit nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike në fushën inxhinierike, menaxhimit të ujit, menaxhimit financiar dhe prokurimit të mallrave. Gjithashtu, Projekti do të mbështesë rritjen e pagesave për stafin dhe sigurimin e mjeteve dhe bazës teknike.

5. Shërbime inxhinierike për projektimin dhe supervizionin e punimeve të Projektit.

Projekti ka filluar në mes të vitit 1999 dhe pritet të mbarojë në 30 qershor 2002.

LETËR NR.1

Republika e Shqipërisë

Data 5.2.2001

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

P.O.Box 2921, Safat

Kuvajt, 13030

Të dashur zotërinj,

Subjekti: Lista e mallrave për t'u financuar nga Huaja

- Procedura për prokurim

Duke iu referuar paragrafeve 3.06 dhe 4.07 të Marrëveshjes së Kredisë lidhur me Projektin e Dytë të Rehabilitimit të Ujitjes (Faza II), që është firmosur sot midis Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab dhe Shqipërisë, ne konfirmojmë që të ardhurat nga Huaja do të shpërndahen për financimin e mallrave dhe shërbimeve sipas listës së bashkëngjitur në përqindjet dhe shumat e përmendura këtu, të cilat kohë më pas kohe mund të përmirësohen me aprovimin e Fondit, duke parashikuar që këto rregullime nuk do të rrisin shumën e Huasë.

Ne, gjithashtu, konfirmojmë që asnjë e ardhur e Huasë nuk do të përdoret për pagesat e taksave e detyrimeve të imponuara nga ligjet në fuqi të Shqipërisë.

Ne, gjithashtu, konfirmojmë se kontratat për pajisje dhe pjesë këmbimi do të financohen nga Huaja, për shuma që kalojnë vlerën prej 25 000 Dinarë Kuvajtian do të prokurohen, përveç rasteve

ku është rënë dakord ndryshe, nëpërmjet tenderit internacional. Për shuma më të vogla se 25,000 Dinarë Kuvajtian mund të prokurohet edhe me tenderim të drejtpërdrejtë nga ndonjë numër furnizuesish apo prodhuesish të përshtatshëm për këto lloje pajisjesh, me kusht që vlera agregate e këtyre zërave që do prokurohen në mënyrë të tillë mos kalojë shumën ekuivalent me 300,000 Dinarë Kuvajtian.

Fondi konfirmon se, përderisa nuk do të bihet dakord ndryshe, prokurimi i të gjitha zërave të punimeve që do të financohen nga Huaja do të vazhdojë të kryhet mbi bazë të tenderimit lokal në përputhje me procedurat e prokurimit të pranueshme nga Fondi.

Përsa i përket zbatimit të Paragrafit 4.07 të referuar më sipër, prokurimit të zërave që do të financohen nga Huaja, ne do t'ju pajisim me një kopje të dokumenteve të tenderit për të gjitha vlerat,

që do të kalojnë shumën ekuivalente me 25,000 Dollarë Kuvaitianë në avancë, me qëllim që të shqyrtohet, komentohet dhe të bëhen modifikime të tilla sa mund të kërkohen nga ju në këto dokumente ose në procedurën e ofertës. Pas marrjes dhe analizës së ofertave, ne do t'ju pajisim me një raport të hollësishëm të vlerësimit të ofertave, bashkë me rekomandimin për fituesin për mendimin dhe miratimin tuaj. Gjithashtu, çdo modifikim që do të propozohet për t'u bërë në lidhje me kushtet e ndonjë kontrate para ose pas lidhjes do të paraqiten për miratimin tuaj.

Në vazhdim të nënshkrimit të kontratave, ne do t'ju pajisim me kopjet që konfirmojnë nënshkrimin e tyre për efekt dokumentacioni dhe shpenzim nga Huaja lidhur me to.

Me qëllim që të sigurohet në kohë nënshkrimi i kontratave për ekzekutimin e Projektit, do të përpilohet një program për fazat e tenderimit, vlerësimit të ofertave, nënshkrimit të kontratave të mëdha dhe ne të do të ndërmarrim të gjitha hapat e nevojshme për t'ju përmbajtur këtij programi si dhe do t'ju pajisim me një kopje të tij.

Lutemi, konfirmoni se jeni dakord për sa më sipër dhe për "Listën e mallrave të bashkangjitur", duke nënshkruar formularin e konfirmimit në kopjen e mbyllur me këtë letër dhe duke na e kthyer atë.

Republika e Shqipërisë

Nga Anastas Angjeli

(Përfaqësuesi i Autorizuar)

Ministër i Financave

Konfirmuar:

Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab

Nga Abdul wahab Al-Bader

(Përfaqësuesi i Autorizuar)

Zv/drejtor i përgjithshëm

Lista e mallrave

Nr	Emërtimi	Caktimi i Çmimit (në Dinarë Kuvajtianë)	Përqindja e kostos totale
1	Punime civile në ujitje dhe kullim	2 700 000	100%
2	Pajisje pompash dhe pjesë këmbimi	300 000	100%
3	Kontigjent fizik	500 000	
	SHUMA	3 500 000	